



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 046/26 Dt. 29.01.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Beledijesi

PLANI I PËRDITËSUAR I INTEGRITETIT

2026

KOMUNA E PRIZRENIT

PËRMBAJTJE:

I. DEKLARATA E INTEGRITETIT	3
II. HYRJE	5
III. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	6
1. Qëllimi i Planit të Integritetit.....	7
2. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	7
3. Metodologjia dhe procesi	8
4. Metoda e vlerësimit të rrezikut.....	9
5. Përzgjedhja e masave	10
6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi	11
7. Fushat e rrezikut	11
7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut	11
7.2 Fushat specifike të rrezikut.....	11

I. DEKLARATA E INTEGRITETIT

Komuna e Prizrenit e vlerëson konceptin e integritetit në mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke mos u fokusuar vetëm në ndershmërinë dhe mungesën e korrupsionit, por edhe në një sërë aspektesh të tjera që përbëjnë menaxhimin publik siç janë: etika, sjella dhe komunikimi profesional, standardet, vlerat, konfidencialiteti, transparenca, paanshmëria dhe llogaridhënia, Garantimi i këtyre parimeve krijon mbrojtëse ndaj korrupsionit.

Përballja efektive me korrupsionin nga ana e Komunës ka rëndësi jetike për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional dhe të mirëqeverisjes, si dhe për mundësimin e ofrimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Fushëveprimi i Komunës në ushtrimin e kompetencave vetanake dhe të deleguara shtrihet në përgatitjen, hartimin dhe miratimin e akteve komunale; zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural; shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin; zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale; përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale; ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e përkujdesit shëndetësor primar publik; ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, si përkujdesi për grupet e cënueshme, strehimin familjar, përkujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale; banimin publik; shëndetësinë publike; licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, përfshirë ato që lidhen me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin publik lokal dhe taksitë; emërimin e rrugëve, rrugicave dhe hapësirave të tjera publike; ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira.

Plani i Integritetit është një dokument që shërben si bazë strategjike dhe operacionale për institucionin në identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të integritetit të tij, duke përfshirë zyrtarët dhe nëpunësit civilë. Ky plan harton masa specifike për trajtimin e këtyre rreziqeve dhe përmbushjen e objektivave strategjike dhe të veçanta të institucionit. Në këtë mënyrë, ai siguron një kuadër të strukturuar dhe efektiv për menaxhimin dhe përmirësimin e integritetit institucional.

Institucionet e vetëqeverisjes lokale kanë ndërmarr hapa të rëndësishëm drejt konsolidimit të institucioneve publike, përmes reformave të rëndësishme, thellimit të luftës kundër korrupsionit, për zgjedhjes dhe trajnimit të punonjësve të administratës publike, si dhe zbatimit të një numri të konsiderueshëm masash të tjera. Megjithatë mbetet shumë për të bërë, për të shmangur çdo mundësi për abuzim dhe për të rritur besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

Rëndësia e këtij Plani Integriteti qëndron, së pari, në përpjekjen e vazhdueshme për ta trajtuar rintegritetin, etikën dhe transparencën si vlera themelore që i shërbejnë mirëfunksionimit institucional të Komunës, si dhe në efektet dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që masat e tij kanë në forcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit.

Plani i Integritetit për Komunën është një mjet kyç për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të korrupsionit dhe shkeljes së integritetit në fushat ku përgjegjësitë janë më të ndjeshme. Ky dokument përcakton qasjen për të kuptuar, zhvilluar dhe implementuar integritetin në strukturat e Komunës, duke specifikuar njëkohësisht mënyrat dhe mekanizmat efektivë për realizimin e këtij qëllimi. Pavarësisht se sfida për të luftuar korrupsionin dhe për të ndryshuar perceptimin ndaj tij mbetet e vazhdueshme, Komuna do të vazhdojë përpjekjet për të rritur proaktivitetin dhe bashkëpunimin ndërinstitutional.

Qëllimi përfundimtar është sigurimi i shërbime cilësore, transparente dhe të paanshme për komunitetin, duke promovuar një kulturë pune në administratën publike që bazohet në integritet, etikë dhe transparencë. Zbatimi i plotë i Planit të Integritetit do të çojë administratën e Komunës një hap përpara drejt përmbushjes së standardeve të dëshiruara për të gjithë.

Shaqir Doda
Kryetar i Komunës



II. HYRJE

Në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit”, e cila obligon të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit. Komuna e Prizrenit ka hartuar dhe miraton Planin e Integritetit për vitin 2026. Plani i Integritetit është dokument i brendshëm me afat një (1) vjeçar dhe i nënshtrohet përditësimit në baza vjetore.

Integritetit është themel i çdo sistemi të mirëqeverisjes, si dhe një nga parimet themelore të sjelljes në institucionet shtetërore, krahas besueshmërisë, ndershmërisë, transparencës, objektivitetit dhe bashkëpunimit. Rritja e nivelit të integritetit në institucionet e vetëqeverisjes lokale është kusht i domosdoshëm për ndërtimin e një administrate publike të konsoliduar dhe efektive.

Roli i rëndësishëm që ka Plani i Integritetit përfshin: përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës institucionale, forcimin e rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit, si dhe planifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të integritetit.

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Strategjinë Kundër Korrupsionit, të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna harton dhe miraton “Planin e Integritetit për periudhën 2026”.

Plani i Integritetit është mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të institucionit dhe është proces i dokumentuar për vlerësimin e nivelit të cënueshmërisë së institucionit dhe ekspozimin e tij ndaj praktikave joetike dhe atyre korruptive. Plani është dokument operativ që ofron masa të mbështetura në rrezik, për të arritur objektivat e integritetit të institucionit. Plani thekson përkushtimin e Komunës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase dhe transparente. Gjithashtu, plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe të vlerave dhe standardeve profesionale.

III. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Komunën është dokument që paraqet standarde profesionale për masat që duhet të zbatohen nga punonjësit e institucionit dhe shërben si mjet për menaxhimin dhe vlerësimin e rrezikut të integritetit.

Plani i Integritetit përfshin përmirësimin e sistemit efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës institucionale, forcimin e rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit, si dhe planifikimin e menaxhimit të rrezikut të integritetit.

Përmes këtij Plani, synohet përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes dhe menaxhimit institucional në çdo hallkë të tij, duke filluar nga proceset e thjeshta të punës e deri të menaxhimi i një sektori apo departamenti të caktuar. Gjithashtu, ai shërben si mjet për promovimin e etikës dhe integritetit brenda institucionit, por edhe si dokument operativ që përcakton masa konkrete për përmbushjen e objektivave për forcimin e integritetit institucional.

Plani kontribuon në realizimin e objektivave organizative të institucionit, duke marrë në konsideratë menaxhimin e rrezikut të integritetit dhe masat konkrete për trajtimin e rreziqeve të evidentuara.

Përgatitja e dokumentit të Planit të Integritetit vlerësohet si një rëndësi e veçantë dhe që mbështet përpjekjet e drejtuesve të Komunës në luftën kundër korrupsionit dhe në konsolidimin e institucioneve në këtë drejtim. Ky dokument synon rritjen e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në strukturat e Komunës.

Integriteti i institucioneve publike përbën një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe është një nga treguesit e mirëfunksionimit të demokracisë. Në kuadër të reformave të administratës publike, forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion rezultojnë të jenë reforma thelbësore. Përmirësimi i elementeve që ndikojnë në forcimin e integritetit, siç janë: aksesit i lirë në informacion, transparenca aktive dhe proaktive, mbrojtja e të dhënave personale, etika, administrimi i mirë i burimeve njerëzore, etj., janë shumë të rëndësishme, duke qenë se konsiderohen si elemente kyçe të shtetit të së drejtës.

1. Qëllimi i Planit të Integritetit

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit, është vlerësimi dhe identifikimi i rreziqeve të integritetit, të cilat mund të komprometojnë aftësinë e Komunës për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.

Qëllimi i Planit të Integritetit në aspektin më të gjerë, synon që:

- të kontribuojë në mënyrë domethënëse në rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative, të forcoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe të zvogëlojë apo eliminojë mundësitë për korrupsion;
- të bëjë kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit duke rritur efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve publike;
- të përqendrohet në prioritetet, bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, me qëllim që Komuna të shpërndajë në mënyrë sa më efektive burimet e disponueshme për parandalimin e dhe t'i shfrytëzojë në mënyrën më mirë të mundshme;
- të krijojë një mjedis të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit për të gjithë stafin, gjatë procesit të zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit të Integritetit.

2. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Hartimi i këtij dokumenti është realizuar nga Grupi i Punës, bazuar në metodologjinë e miratuar me vendim, nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë kontribuar të gjitha strukturat e brendshme të Komunës, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë.

Zhvillimi i Planit të Integritetit është realizuar në disa faza, si vijon:

Faza e parë: Kryetari i Komunës merr vendim për emërimin e Personit Përgjegjës, Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Grupi Punues përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, në varësi të kompleksitetit të institucionit dhe numrit të punonjësve. Me qëllim të përgatitjes së materialit, u hartua një plan pune ku u përcaktuan afatet, masat dhe aktivitetet e planifikuara, duke përfshirë organizimin e takimeve të rregullta të Grupit Punues, diskutimi mbi ecurinë e procesit dhe detyrat e secilës strukturë. Grupi Punues u angazhua për përgatitjen e një analize të thelluar të situatës, duke u bazuar në specifikat e strukturave të përfshira, duke shqyrtuar në mënyrë të detajuar çdo aspekt dhe proces pune, si dhe shërbimet e ofruara, me qëllim evidentimin e problematikave.

Gjithashtu, Grupi Punues, shqyrtoi kornizën ligjore, rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni që lidhen me fushat dhe proceset e punës. U bë mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e planit, si dhe u njoftuan të gjithë punonjësit për rëndësinë e Planit të Integritetit. Në çdo takim u mbajt procesverbal.

- **Faza e dytë:** Grupi Punues shpërndau pyetësin gjithëpërfshirës dhe realizoi intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazë të rezultateve të pyetësit dhe intervistave, përcaktohen fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve. U përpunuan të dhënat e përfituara nga procesi i identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit të rreziqeve të integritetit. Identifikimi i rreziqeve u krye për të gjitha proceset, fushat të ndryshme si dhe për të gjitha nivelet, të vlerësuara si potencialisht të rrezikuara apo të ekspozuara ndaj cenimit të integritetit të punonjësve dhe të institucionit.
- **Faza e tretë:** Grupi Punues përdori të dhënat e siguruar për të përpiluar tabelat e rrezikut, për të adresuar cenueshmërinë e integritetit dhe për të propozuar masat për përmirësim. Rreziqet e identifikuara u konceptuan dhe u kategorizuan në disa grupe e fusha rreziku.

Draftet përfundimtare të Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit, iu nënshtruan procesit të konsultimit të brendshëm, përpara miratimit të tyre.

Në përfundim, institucioni publikon Planin e Integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

3. Metodologjia dhe procesi

Metodologjia

Për hartimin e Planit të Integritetit, si dhe për të analizimin dhe vlerësimin e integritetit dhe sjelljeve joetike në Komunë, Grupi Punues ka përdorur dy metoda kryesore: metodën cilësore dhe metodën sasiore.

Metoda cilësore – Kjo metode përfshinë përdorimin e grupeve të fokusit (diskutime në grup), intervista individuale, si dhe analizën e rregulloreve dhe raporteve të ndryshme. Pjesë përbërëse e metodës cilësore ishte edhe organizimi i:

- a) intervistave me stafin e Komunës, si dhe
- b) shpërndarja e pyetësit përmes email-it zyrtar, i cili iu drejtua nivelit menaxherial të Komunës.

Metoda sasiore – Kjo metodë është përdorur për të identifikuar dhe përcaktuar problemet përmes gjenerimit të të dhënave numerike, të cilat mund të përpunohen dhe të transformohen në statistika të përdorshme për analizë dhe vlerësim.

Rrjedhimisht, në bazë të kombinimit të metodave cilësore dhe sasiore, janë mbledhur informacione të vlefshme për vlerësimin dhe identifikimin e rreziqeve, si dhe për përcaktimin e

6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga zyrtari përgjegjës brenda institucionit, si dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm është thelbësor për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtimin janë efektive, si në fazën e hartimit ashtu edhe në zbatim, që procedurat janë kuptuar dhe që Plani i Integritetit zbatohet në mënyrë të rregullt.

Po ashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut kanë prodhuar efektet e planifikuara, nëse janë identifikuar ndryshime në kontekstin brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, si dhe nëse këto ndryshime kërkojnë rishikimin e trajtimit e masave dhe prioritetëve. Ky proces ndihmon gjithashtu në nxjerrjen e mësimëve të nevojshme për planifikimet e ardhshme.

Raportimi i rregullt siguron që zbatimi i Planit të Integritetit të realizohet sipas afateve të përcaktuara dhe që rezultatet e planifikuara të arrihen.

7. Fushat e rrezikut

Fushat e rrezikut ndahen në dy kategori, si vijon:

7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut përfshijnë:

- Burimet njerëzore;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Auditimi i brendshëm;
- Komunikimi, informimi dhe ruajtja e të dhënave dhe dokumenteve.

7.2 Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike të rrezikut përfshijnë:

- Prokurimi publik;
- Subvencione, grante dhe bursa;
- Ofrimin e shërbimeve në shëndetin publik;
- Arsimi publik;
- Planifikimi urban dhe rural;

-
- Inspektimet;
 - Turizmi dhe zhvillimi ekonomik;
 - Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
 - Shërbimet publike dhe licencimin e tyre;
 - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;
 - Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
 - Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr .	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndiki mi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtar i përgjegjës	Afati i realizimit
1	Burimet njerëzore	Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm	Ligjet dhe aktet nënligjore	5	5	25	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	Në vazhdimësi
		Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve	Ligjet dhe aktet nënligjore	4	5	20	Hartimi i analizës së nevojave për trajnime; trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave; të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të realizuara	Kryetari i Komunës; Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	Në vazhdimësi

		Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e Kodit të Etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të Komunës	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	2	6	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunalë dhe organizimi i takimeve informuese mbi përmbajtjen e Kodit	Kryetari i Komunës; Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Në vazhdimësi
--	--	--	-----------------------------	---	---	---	--	--	---------------

		Mungesa e informimit dhe mosraportimi i dhuratave nga qytetarët te punonjësit e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës)	Ligjet dhe aktet nënligjore	9	8	72	Njësia për Burime Njerëzore krijon një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuar nga nëpunësit; informimi i stafit për rregullat e pranimi dhe raportimit të dhuratave.	Njësia e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publikë	Në vazhdimësi
--	--	--	------------------------------------	----------	----------	-----------	--	---	----------------------

		Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	3	9	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin e mekanizmave të raportit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. Nënshkrimi i deklaratës së integritetit nga të gjithë nëpunësit publikë ekzistues dhe të rinj	Kryetari i Komunës; drejtuesit e drejtorive; Njësia e Personelit	Në vazhdimësi
--	--	--	-----------------------------	---	---	---	---	--	---------------

2	Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Ndikimi i vendimmarrjes nga niveli qendror në nivelin lokal, që ndikon në zvogëlimin e efikasitetit në punën e Komunes	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet komunale	3	5	15	Intensifikimi i takimeve të koordinimit në vendimmarrje ndërmjet dy niveleve dhe ndërmarrja e masave ligjore.	ZKA, ZKF	Në vazhdimësi
		Mosplanifikimi i detajuar i planit të shpenzimeve	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet komunale	3	3	9	Organizimi i takimeve vetëdijësuese me stafin për hartimin e planit të zotimeve dhe shpenzimeve	Programet dhe nënprogramet	Në vazhdimësi
		Mungesa e koordinimit ndërmjet drejtorive/njësive në planifikimin buxhetor dhe barazimin e të hyrave	Ligjet e aplikueshme	3	4	12	Formimi i grupeve punuese profesionale në fusha të caktuara dhe caktimi i zyrtarëve përgjegjës për barazime të hyrave	ZKA, Drejtorët	Në vazhdimësi

		Mangësi në procesin e inventarizimit dhe regjistrimit të pasurisë komunale	Rregullorja nr.. 02/2013- për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore	4	5	20	Formimi i komisionit për inventarizim brenda afatit ligjor; regjistrimi i të gjitha pagesave kapitale në sistemin SIMFK	Komisioni për inventarizim, Zyrtari i pasurisë	Në vazhdimësi
		Ekzekutimi i mjeteve nga ana e përmbaruesit privat	Ekzekutimi i mjeteve nga projektet kapitale	3	3	9	Lejimi nga Ministria i buxhetimit që rrjedh nga kontrata kolektive	Ministria e Financave, ZKA, ZKF	2026
3	Auditimi i brendshëm	Mos përgatitja e planeve strategjike dhe propozim-planeve strategjike dhe vjetore të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut	Ligji për Kontrollin te Brendshëm të Financave Publike 06/L021	2	6	12	Planifikim i vazhdueshëm i auditimit bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut; monitorimi i zbatimit të planit dhe ndërmarrjet e masave përmirësuese sipas nevojës	Njësia e Auditimit (hartimi i planeve) Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim).	Në vazhdimësi

		Mos përfshirja e të gjitha fushave dhe drejtorive në planin strategjik dhe vjetor të auditimit për shkak të pamjaftueshmërisë së auditorëve të brendshëm	Ligji nr. 06/L021 dhe Rregullorja QRK nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publikë	6	9	54	Rekrutimi i së paku një auditori të brendshëm shtesë; qëllimi o përmbushjes së objektivave të auditimit, organizata buxhetore(Komuna) duhet të shtoj staf profesional(auditor të brendshëm të certifikuar) në njësinë e auditimit të brendshëm, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Rregulloren QRK nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e	Kryetari i Komunës; Njësia për Burime Njerëzore	Në vazhdimësi
--	--	--	--	---	---	----	---	---	---------------

						sektorit publikë		
--	--	--	--	--	--	---------------------	--	--

		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të drejtorive	Ligji për 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, UA MF nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Rregullore (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm	5	6	30	Përmirësimi i sistemit të komunikimit mes njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe organeve të tjera komunale; mbajtja e takimeve koordinuese të rregullta	Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit, Drejtorët e drejtorive.	Në vazhdimësi
4	Komunikimi, informimi dhe ruajtja e të dhënave dhe dokumenteve	Mosfunksionimi i ueb-faqes zyrtare të Komunës.	Udhëzimet administrative në fuqi	5	8	40	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht (MAPL dhe ASHI).	Zyra e Kryetarit	Në vazhdimësi

		Pamundësia e publikimit me kohë të dokumenteve që lidhen me afate ligjore dhe procedurale	Aktet nënligjore	5	8	40	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht (MAPL dhe ASHI)	Zyra e Kryetarit	Në vazhdimësi
		Mungesa e trajnimeve për punën me të dhënat personale dhe mbrojtjen e tyre	Ligjet dhe aktet tjera nënligjore	3	8	24	Sigurimi i trajnimeve për stafin lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Zyra e Kryetarit, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Mos publikimi me kohë i dokumenteve për organizimin e takimeve publike, dëgjimeve publike si dhe konsultimeve publike	Ligjet dhe aktet tjera nënligjore	4	8	40	Zbatim i plotë i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04.2023 për Administratë të Hapur	Zyra e Kryetarit	2026

FUSHAT SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr .	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1	Prokurimi publik	Mungesa e stafit të kualifikuar për menaxhimin e kontratave (ndarë në drejtori)	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet komunale	3	8	24	Caktimi i stafit profesional, të certifikuar dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim kontratash	Drejtorja e Administratës	Në vazhdimësi
		Vonesa në hartimin e planit të prokurimit	Afatet ligjore	3	5	15	Hartimi me kohë të kërkesave nga programet dhe nën programet, angazhimi: angazhimi i hershëm i stafit në hartimin e planit të prokurimit	Programet dhe nën- programet	Në vazhdimësi

		Përgatitja joefikase e specifikave teknike nga njësia e kërkesës	Ligjet dhe aktet tjera nënligjore	7	9	63	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit; hartimi i projekteve detale.	Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurimit	Në vazhdimës i
		Caktimi i zyrtarëve jo profesional për menaxhim të kontratave	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	5	5	25	Caktimi i zyrtarëve profesional sipas fushës së kontratës; trajnime të vazhdueshme	Zyra e Kryetarit; Njësia e Personelit	Në vazhdimës i
		Komisione jo profesionale për vlerësimin e ofertave	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	6	8	48	Caktimi i zyrtarëve profesional për vlerësimin e ofertave	Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurimit	Në vazhdimës i
		Mungesë transparence dhe konkurrence gjatë procedurave të prokurimit për shkak të kritereve të paqarta të tenderuesve	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	5	10	52	Publikim i plotë i dokumentacionit; standardizim i kritereve; trajnime; forcim i kontrolleve të brendshme	Njësia e Kontrollit të Brendshëm-Prizren	2026

		Kritere të paqarta ose diskriminuese në dosjet e tenderit që kufizojnë konkurrencën	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	5	16	20	Standardizimi i kritereve dhe shqyrtimi paraprak i dosjeve nga kontrolli i brendshëm	Njësia e Kontrollit të Brendshëm	2026
		Ndikimi i jashtëm dhe mosdeklarim i konfliktit të interesit dhe mbikëqyrjeje e rregullt e procedurave të prokurimit	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	10	23	48	Zbatimi rigoroz i deklarimit të konfliktit të interesit dhe monitorim i rregullt i procedurave	Autoriteti Kontraktues/ Komisionet e vlerësimit	2026
		Mungese e kapaciteteve profesionale të stafit të prokurimit	Ligji dhe rregullorja e prokurimit publik	15	40	48	Trajnime të rregullta profesionale dhe certifikimi i stafit	Zyra për Burime Njerëzore; Autoriteti Kontraktues	2026
2	Subvencion, grante dhe bursa	Moszbatimi i rregulloreve komunale dhe të ministrisë për ndarjen e subvencioneve	Rregullore MF - NR - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve	6	8	48	Respektimi i kritereve të përcaktuara në rregullore	Të gjitha drejtoritë komunale që japin subvencione	Në vazhdimës i

		Mungesa e monitorimit	Rregullore MF - NR - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve	6	8	48	Angazhimi i stafit nga jashtë dhe blerja e shërbimeve kontraktuale	Të gjitha drejtoritë komunale që japin subvencione	Në vazhdimës i
3	Ofrimi i Shërbimeve në Shëndetin Publik	Mosfunksioni mi adekuat i SISH-it	Ligji për Shëndetësi; UA 04/2020 për Shëndetësin e Primare; Koordinator i i SISH-it	3	5	15	Shtirja e rrjetit të internetit dhe pajisja me PC e të gjitha njësive shëndetësore; trajnimi i stafit për përdorimin e sistemit	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	Në vazhdimës i
		Pagesat për shërbime shëndetësore të dokumentuara në mënyrë manuale	Mungesa e programeve të kontabilitetit	6	8	48	Krijimi i programeve për inkasim elektronik të participimeve për shërbimet shëndetësore	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	Në vazhdimës i

4	Arsimi publik	Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve.	Planifikimi me kohë i DKA-së	7	10	70	DKA nuk do të shpallë konkurse të reja; fillimisht, do të sistemohen mësimdhënësit që mbesin pa normë si pasojë e rënies së numrit të nxënësve	DKA dhe shkollat	Në vazhdimës i
		Pamundësia e planifikimit adekuat për numrin të lehonave dhe pushimeve tjera sipas Ligjit të Punës nr. 04/L-212	Njoftimi i drejtorëve të shkollave sipas informatave që kanë	6	9	54	Marrja e masave për zëvendësime adekuate nga stafi ekzistues që kanë mungesë norme.	DKA dhe shkollat	Në vazhdimës i
		Mungesa e çerdheve publike në komune për të mbuluar numrin e fëmijëve në institucione publike	Planifikimi në kodet buxhetore	4	4	16	Planifikimi buxhetore; identifikimi i parcelave	DKA/MASHTI	2026
		Mungesa e burimeve njerëzore, zyrtarëve arsimorë për inspektim në	Mungesa e zyrtarëve arsimorë	5	8	40	Rritja e resurseve njerëzore	Kryetari/ Njësia për Burime Njerëzore/ DKA/ Shkollat	2026

		institucionet arsimore							
		Strategjia Komunale për përfshirje dhe mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta	Numri i madh i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore	7	10	59	Përpilimi i strategjisë komunale në përputhje me procedurat administrative në Asamblenë Komunale.	DKA	2026
		Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë	Planifikimi i buxhetit				Përmirësimi i pagave dhe kushteve të punës, zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, dialogu social dhe bashkëpunimi me sindikatat, programet e avancimit profesional	MASHT / MFPT/ DKA/ MSHT	2026

5	Planifikimi urban planifikimit hapësinor	Mangësi në rregullativën e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban, rural, ndërtim dhe banim	Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe aktet e brendshme të komunës	4	9	36	Hartimi dhe zhvillimi i rregullativës së brendshme me kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore dhe parandalojnë veprimet subjektive	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm	Në vazhdimës i
		Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhet me planifikimin urban, rural banim dhe ndërtim	Ligjet dhe aktet nënligjore e në fuqi, si dhe aktet e brendshme të komunës	5	9	45	Sigurimi i trajnimit të stafit në fushën e planifikimit urban rural, ndërtim dhe banim	Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm; Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimës i

		Kuadro i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban, rural banim dhe ndërtim	Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës	3	9	27	Te sigurohet staf bashkëpunëtor profesional shtesë adekuat lidhur me planifikim hapësinor dhe urbanizëm	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm; Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimës i
		Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet (vend punishtet)	Ligjet dhe aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës dhe planet gjenerale urbane	7	9	63	Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Në vazhdimës i

6	Inspektimet	Planifikimi jo i duhur i inspektimeve	Ligjet, dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe aktet e brendshme të komunës	5	6	30	Plani vjetor i punës për Drejtorinë e Inspekcionit të bazohet në metodologjinë e bazuar në rrezik dhe të përfshij informacione relevante	Drejtoria e Inspekcionit; Udhëheqësit e sektorëve	Në vazhdimës i
		Kapaciteti i pamjaftueshëm profesional i inspektorëve	Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe aktet e brendshme të komunës	7	8	56	Angazhimi në trajnime profesionale.	Drejtoria e Inspekcioni; Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimës i
		Stafi i pamjaftueshëm -numri i vogël i inspektorëve	Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe aktet e brendshme të komunës	6	7	42	Rekrutimi i numrit të mjaftueshëm dhe profesional i inspektorëve.	Drejtoria e Inspekcioni; Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimës i
		Transparencë jo e plotë, për punën e njësisë së inspektimit	Ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe aktet e brendshme të komunës	6	7	42	Publikimi i listës vjetore të bizneseve të inspektuara dhe realizimit të planit në përqindje	Drejtoria për Inspekcion; Zyra për Informim.	Në vazhdimës i

7	Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik	Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal	Ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe aktet e brendshme të komunës	8	9	72	Hartimi, rishikimi, përditësimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës; mungon strategjia për zhvillim ekonomik	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	Në vazhdimës i
		Qëllime dhe prioritete të paqarta dhe jo transparente të zhvillimit ekonomik të komunës	Ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe aktet e brendshme të komunës	6	8	48	Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës dhe sigurimi i pjesëmarrjes së të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	Në vazhdimës i

		Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të komunës	8	8	64	Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal; të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik; Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimës i
		Mbikëqyrja joefikase mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të komunës	3	5	15	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	Në vazhdimës i
		Planifikimi strategjik në turizëm dhe zhvillim ekonomik	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029	4	9	36	Përditësimi i dokumenteve strategjike për turizëm dhe zhvillim ekonomik lokal	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2026

		Transparenca dhe përfshirja e pamjaftueshmë e palëve të interesit	Ligji nr. 08/L-074 për Turizëm	5	16	48	Sigurimi i pjesëmarrjes së palëve relevante në hartimin e prioriteteve të zhvillimit	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2026
		Kapacitetet njerëzore institucionale	Ligji nr. 08/L-074 për Turizëm	9	18	48	Trajnimi i stafit dhe rritja e kapaciteteve profesionale në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik	Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik; Njësia e Burimeve Njerëzore	2026
		Mbikëqyrja dhe raportimi jo i mjaftueshëm i aktiviteteve në turizëm	Ligji për Punë	10	16	48	Kontrolli dhe raportimi i rregullt mbi zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve turistike	Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2026

9	Shërbimet Publike dhe licencimi i tyre	Menaxhimi i pamjaftueshëm në menaxhimin e mbeturinave		5	9	45	Rritja e rrezikut në menaxhimin e mbeturinave; përmirësimi i kornizës strategjike përmes hartimit të rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave; sigurimi i kontrolleve strikte dhe rritja e llogaridhënies së operatorëve	Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike- Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Mjedisit	Në vazhdimës i
		Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve		4	9	36	Zhvillimi i rregullativës së brendshme me kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit dhe parandalojnë vendimmarrje subjektive	Kryetari i Komunës; Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve	Në vazhdimës i

		Mungesa dhe mosshtrirja e plotë e rrjetit të kanalizimit në tërë territorin e Komunës së Prizrenit, duke shkaktuar ndotje të mjedisit dhe rrezik për shëndetin publik, pasi ujërat e zeza fekale në disa zona urbane dhe rurale derdhen drejtpërdrejt në lumenj dhe përrenj		15	36	49	Hartimi dhe zbatimi i një plani të integruar për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në zonat e pambuluara, përfshirë projektin teknik, sigurimin e buxhetit, ndërtimin e infrastrukturës, dhe lidhjen me sistemet ekzistuese të trajtimit të ujërave të ndotura.	Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me KRU "Hidroregjioni Jugor"	2026
		Ngarkesa e lartë e komunikacionit rrugor, infrastruktura e pamjaftueshmë e rrugore dhe përdorimi i mjeteve të vjetruara transportuese		20	30	70	Hartimi dhe zbatimi i masave për menaxhimin e qëndrueshëm të komunikacionit, përfshirë përmirësimin e infrastrukturës rrugore, promovimin e transportit publik dhe alternativ	Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës	2026

		që rrisin ndotjen e ajrit (PM10, PM2.5, NO ₂ , CO), duke ndikuar negativisht në shëndetin e qytetarëve dhe cilësinë e jetesës, veçanërisht në zonat urbane me qarkullim të dendur					(biçikleta, ecje), rregullimin e qarkullimit në zonat e ngarkuara dhe reduktimin e përdorimit të automjeteve me emetime ndotëse		
10	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Mosdefinimi i qartë i statusit të OJQ-ve	Rregullim dhe harmonizim të rregulloreve – specifikim sipas aktiviteteve.	3	5	15	Formimi i komisioneve për hartimin e rregulloreve lokale	DKRS	Në vazhdimës i
		OJQ-të dhe organizatat sportive nuk zgjidhen rregullisht	Ligjet dhe aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	3	3	9	Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive	DKRS	Në vazhdimës i

		Plani njëvjeçar i punës së DKRS-së me objektivat dhe dikastere; nevoja për avancim të bashkëpunimit me OJQ-të	Ligjet dhe aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	3	4	12	Përmirësimi i kornizës strategjike për Kulturë, Rini dhe Sport përmes hartimit të Planit të Veprimit Komunal; planifikimi vjetor i aktiviteteve të dedikuara për të rinjtë	DKRS	Në vazhdimës i
		Numri i pamjaftueshëm i programeve për integritetin, etikës dhe pajtueshmërisë për të rinjtë	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	4	5	20	Zbatimi i programeve dhe fushave për integritetin, etikë dhe pajtueshmërisë të dedikuara për të rinjtë	DKRS	Në vazhdimës i

11	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Moszbatimit efektiv i ligjeve për mbrojtjen e tokave bujqësore për shkak të paqartësisë së kompetencave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal	Ligjet dhe aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	4	5	20	Koordinimi dhe definimi i qartë i kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal; ndalimi i degradimit të tokave bujqësore dhe rehabilitimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes.	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	2026
		Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit të përdorimit të tokave		6	7	42	Rritja e kontrollit dhe monitorimit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Në vazhdimës i

12	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Mungesa e fondit emergjent për shërbime sociale	Vendime, ligje dhe rregullore	3	6	18	Krijimi i fondit	Niveli Lokal; Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2026
		Menaxhimi i joefikas i rasteve sociale dhe shërbime sociale	Komisione, grupe punuese, raporte për gjendjen aktuale	6	7	42	Mungesa e garantit specifik në kuadër të DPMS-së, funksionalizimi i QPS-së II. Funksionalizimi i shtëpisë së pleqve, funksionalizimi i banesave sociale	Kryetari i Komunës; Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2026
		Vështirësi në realizimin e objektivave të DPMS, për shkak të mungesës së stafit	Planet e rekrutimit	12	42	56	Rritja e stafit në DPMS ,QPS dhe QPS 2	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2026

		Zgjidhja e pamjaftueshm e çështjes së banimit për qytetarët me cenueshmeri, për shkak të zvogëlimit të rasteve të dhunës dhe uljes së problemeve të rasteve me cenueshmeri.		10	24	65	Ndërtimi i 50 shtëpive individuale dhe një ndërtese për banim sociale	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2026
--	--	---	--	----	----	----	---	--	------